

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË**  
**“GoToYou Beauty Agency” sh.p.k**

Ne mbështetje të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, vendosa hartimin e këtij Akti Themelimi, me kushtet që përcaktohen si më poshtë:

Sot ne date 12.09.2023, ortaket e shoqerise:

z. **Maurizio Stefanelli** lindur më 03.09.1965, në Tricase (Lecce), dhe banues në Itali, me karte identiteti Nr.CA45261DB.

z. **Riccardo Stefanelli**, lindur më 02.01.2001, në Tricase (Lecce), dhe banues në Itali, me karte identiteti Nr.CA58179DA.

me vullnetin e tyre te lire dhe te plote, te shprehur nepermjet ketij akti themelimi, vendosi per krijimin e shoqerise tregetare " GoToYou Beauty Agency" Shpk me kushtet e meposhteme:

**Neni 1**  
**EMERTIMI**

Shoqeria Tregtare do te ketë Emërtimin “ GoToYou Beauty Agency “ Shpk.

**Neni 2**  
**FORMA JURIDIKE**

Shoqëria Tregtare " GoToYou Beauty Agency" Shpk, themelohet si Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar sh.p.k. Shoqëria është Person Juridik Privat Shqipëtar. Shoqëria krijohet në bazë të Ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ku ne nenin 3 percaktohet se:

” 1. Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomikë të përbashkët, duke dhënë kontributë në shoqëri, sipas përcaktiveve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksionar të vetëm). ”

2. Shoqëritë tregtare duhet të regjistrohen sipas nenit 22 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe neneve në vijim, sipas formës përkatëse të shoqërisë tregtare.

3. Shoqëritë tregtare fitojnë personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëritë përgjigjen me të gjitha aktivet e tyre për detyrimet, që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara.”

**Neni 3**  
**KOHEZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë " GoToYou Beauty Agency" Sh.p.k do te vazhdoje veprimtarine e saj me një afat kohor te pakufizuar.

*Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :*

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të ortakeve te shoqerise;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket e shoqerise marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “Shoqeri ne likuidim e siper”.  
Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.  
Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket e shoqerise.

Nëse Ortaket e shoqerise nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 4  
SELIA**

Shoqëria Tregtare “**GoToYou Beauty Agency**” Sh.p.k e ka selinë ne qytetin e Vlores, : Lagjja:Pavaresia,Rruga Gjergj Araniti, Pallati Nr.26.Kati 3.nr.8,Vlore.” Tel :0695274146 email : stefaline@tiscalit.it Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakeve te Shoqerise.

**Neni 5**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:

- **Aktivitet ne fushen e tregetise: Turizem shendetor,Angjensi Turistike,Agjensi Imobiliare,Dhenie automjetesh me qera,Guida Turistike.**

**Neni 6  
KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte i perbere nga kontributi i ortakeve themelues me vleren **100,000 lekë** dhe perbehet nga dy kuota:

- **Maurizio Stefanelli** eshte zoterues e 1 kuote me vlore 50,000 qe perben 50 % te kapitalit themeltar
- **Riccardo Stefanelli** eshte zoterues e 1 kuote me vlore 50,000 qe perben 50 % te kapitalit themeltar

**Neni 7  
TRANSFERIMI I KUOTEVE**

Kuotat e kapitalit jane lirisht te Transferueshme ndermjet Ortakeve. Ortaku qe kerkon te shese kuoten e tij nje personi te trete, duhet detyrimisht tu njoftoj ortakeve te shoqerise blerjen e kuotave te tij ne te njejtat kushte si personit te trete te cilit deshiron t'ia shese. Kur disa ortake ushtrojnë te drejten e tyre te parablerjes dhe shprehin deshiren e tyre per te blere ai deshiron ti shese totalisht ose pjeserisht kuoten, ortaku shites gezon te drejten diskrecionale per te zgjedhur se cilit ortak ai deshiron ti shese totalisht ose pjeserisht kuotat e tij. Ortaket duhet te pergjigjen brenda 30 diteve nese deshironjne te blejne kuotat e ofruara apo jo.

**Neni 8**

**SHPERNDARJA E FITIMIT**

Ortaket financojne, perfitojne rimbursim te financimit te tyre dhe ndajne fitimin e tyre ne baze te kuotave ne kapitalin themeltare.

**Neni 9**

**ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE**

Organet Drejtuese te Shoqërisë janë:

- 1.Administratori,
  - 2.Asamblea e Pergjithshme e Zakonshme ose e Jashtezakonshme e Ortakeve.
- Aministrator i Shoqërisë është Z. Maurizio Stefanelli e datëlindjes 03/09/1969 shtetas Italian mbajtës i dokumentit karte Identiteti me Nr. CA45261DB, me një mandate 5 vjecar me të drejtë ripërtëritje.**

**Neni 10**

## KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administrator ushtron kompetenca ne emer te Shoqerise:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatis dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut te vetem edhe ne rastet kur:

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- b) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,
- c) Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.
- d) Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

### Neni 11

Veprimtaria ekonomike dhe financiare e shoqerise ndahet ne perjudha financiare 12 mujore. Viti financiare fillon nga data 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik, me perjashtim te vitit te pare i cili fillon nga data e krijimit te shoqerise dhe mbaron me 31 Dhjetor.

### Neni 12

Shoqeria mban dokumentacionin e nevojshem financiar per administrimin e pasurise dhe per zhvillimin e te gjithe veprimtarise se saj, ne perputhje me kerkesat e te gjithe legjislacionit perkates ne fuqi.

Bilanci finanziar i shoqerise perpilohet ne baze te raportit me shkrim te eksperteve kontabel te autorizuar dhe te raportit te paraqitur nga administratoret brenda dates 31 mars te vitit pasardhes. Te dy raportet paraqiten me miratohen ne asamblene e ortakeve brenda dates 30 qershor.

Fitimi neto i shoqerise llogaritet mbasi zbriten humbjet e mundshme te vitit te meparshem, shlyerja e te gjitha detyrimeve fiskale dhe ndaj cdo personi te trete, si dhe fondet financiare qe perbejne rezerven e detyrueshem.

**Neni 13**

**ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

Mosmarrveshjet lidhur me themelimin dhe zhvillimin e veprimtarise se shoqerise zgjidhen nga vete ortaket e shoqerise me mirekuptim, dhe kur kjo nuk arrihet ato zgjidhen nga gjykata ne territorin e se ciles ndodhet selia e shoqerise.

**Neni 14**

Ky Akt Themelimi u hartua në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën Shqipe.

**ORTAKET E SHOQËRISË "GoToYou Beauty Agency" Sh.P.K**

**Maurizio Stefanelli**



**Riccardo Stefanelli**

